

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Novobërdës 2012

Qershor, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Debatimi në “Jeta në Kosovë” për Komunën e Novobërdës është transmetuar në RTK më 27 qershor 2012.

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	3
2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuara gjatë fushatës elektorale 2009...	4
2.1. Mungesa e ujit të pijes	4
2.2. Mungesa e transportit publik.....	5
2.3. Mbeturinat.....	6
2.4. Gurëthyesi.....	6
2.5. Mungesa e përkujdesjes ndaj objekteve historike	7
3. Performanca buxhetore e Komunës së Novobërdës.....	7
3.1. Investimet kapitale.....	8
3.2. Menaxhimi me paranë publike	9
3.3. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011	12
4. Arsimi	14
5. Shëndetësia	14
6. Administrata komunale	15
7. Transparenca	16
8. Puna e Kuvendit Komunal	17
9. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre	19
10. Burimet	22

1. Përmbledhje ekzekutive

Novobërda është Komunë me popullatë të përzier Shqiptare, Serbe, Turke dhe Rome. Është në lindje të Kosovës dhe kufizohet me Prishtinën në Veri, Lipjanin në Perendim, Gjilanin në Jug dhe Kamenicën në Lindje. Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, rezulton se Komuna e Novobërdës ka 6.720 banorë.

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetar i Komunës z. Bajrush Ymeri (LDK), elektoratit i pat prezantuar program zhvillimor dhe me shumë premtime, megjithëse ishte i vetëdijshëm se kapacitetet financiare të Komunës së Novobërdës janë të vogla. Duke regjistruar të gjitha premtimet të dhëna gjatë fushatës zgjedhore, në maj 2010 Instituti GAP dhe BIRN i dërguan një letër të hapur Kryetarit të Komunës së Novobërdës z. Ymeri, duke ia përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna dhe njëkohësisht duke kërkuar realizimin e tyre. Premtimet e dhëna kryesisht janë premtime të përgjithshme. Përkundër përpjekjeve dhe investimeve përgjatë këtyre dy vite e gjysmë, nuk mund të konsiderohen si premtime plotësisht të përmbushura. Në këtë mënyrë, nga dhjetë premtimet të cilat kemi arritur t'i evidentojmë gjatë fushatës elektorale 2009 dhe të cilat i kemi monitoruar që nga atëherë e deri në qershor 2012, katër nga premtimet e dhëna nuk kanë filluar fare së realizuari, kurse gjashtë premtime të tjera janë realizuar pjesërisht.

Pas decentralizimit, me ç'rast Komunës së Novobërdës iu bashkuan territore të Komunës së Kamenicës dhe Gjilanit, të hyrat vetanake të Komunës së Novobërdës kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Rritja e të hyrave ka bërë që të rriten edhe investimet kapitale në këtë komunë. Komuna e Novobërdës për këto dy vite e gjysmë nuk ka arritur të evitojë problemet në menaxhimin e parasë publike. Raportet e Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Novobërdës gjejnë mangësi të shumta sa i përket evidentimit të të hyrave dhe shpenzimeve të parasë.

Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e kësaj komune është mungesa e ujit të pijes. Përkundër investimeve të bëra në këtë periudhë, problemi i ujit të pijes ende nuk është zgjidhur tërësisht.

Komuna e Novobërdës ka potencial për zhvillimin e turizmit malor, mirëpo në mungesë të investimeve, kjo Komunë nuk po mundet të shfrytëzojë potencialin e saj për zhvillim ekonomik.

2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuara gjatë fushatës elektorale 2009

Në prag të fushatës zgjedhore 2009, Instituti GAP kishte zhvilluar një anketë me banorët e Komunës së Novobërdës për të identifikuar pesë problemet kryesore me të cilat përballet kjo komunë.¹ Nga kjo anketë kishte rezultuar se pesë problemet më të mëdha të kësaj komune ishin:

1. Mungesa e ujit të pijes;
2. Mungesa e transportit publik;
3. Mbeturinat;
4. Veprimtaria e gurëthyesit;
5. Mungesa e përkujdesjes ndaj objekteve historike.²

2.1. Mungesa e ujit të pijes

Një nga shqetësimet më të mëdha të banorëve të komunës së Novobërdës ishte mungesa e ujit të pijes. Ky problem ishte potencuar sidomos nga banorët e ndërtesave kolektive në qytetin e Novobërdës, por edhe banorët fshatit Bunjak, lagjet “Kolonja e Re” dhe “Kolonja e Vjetër”, Pllavica dhe qyteti i vjetër. Problemi më i madh me rrjetin e ujësjellësit në Komunën e Novobërdës është mungesa e menaxhimit të tij nga një kompani publike. Kjo ka bërë që vetë banorët të organizohen në menaxhimin e ujësjellësit, megjithëse në pjesën më të madhe të komunës mungon menaxhimi. Komuna intervenon me vonesë për sanimin e prishjeve, kurse nuk ekziston një sistem i pagesës për faturat e rrymës së shpenzuar për operimin e pompave të ujësjellësve.

Më 2011 Komuna e Novobërdës ka investuar mbi 102 mijë euro në renovimin e rrjetit të ujësjellësit në Novobërdë. Por, problemet me ujësjellës mbeten thuajse të njëjta. Më 2011 ka përfunduar rregullimi i ujësjellësit për fshatrat Qylkoc dhe Tullarë. Numri i përgjithshëm i shtëpive të lidhura në këtë rrjet të ujësjellësit është afër 40 sosh. Numri i pakët i shtëpive dhe mos pagesa e faturave të rrymës për operimin e pompave të ujësjellësit ka bërë që KEK të shkyç ujësjellësin nga rrjeti dhe për shumë muaj banorët e këtyre lokaliteteve janë përballur me mungesë të ujit.

Edhe më tutje banorët e lagjes “Kolonja e Vjetër”, “Kolonja e Re”, Pllavica dhe lagja “Mehmetaj” përballen me mungesë të ujit të pijes në pjesën më të madhe të kohës. Më

¹ Instituti GAP. “Novobërda – Raporti Komunal 2009. Nëntor 2009. Burimi:

http://institutigap.org/repository/docs/Novoberda-raporti_komunal.pdf

² Gjatë intervistave me qytetarë, si probleme më madhore ishin potencuar problemet si: papunësia, rrjeti dobët i energjisë elektrike, varfëria, etj. Mirëpo në raportin e GAP të 2009 këto probleme nuk janë listuar për arsye se zgjidhja e këtyre problemeve nuk është kryesisht në kompetencë të kryetarit të komunës. Andaj në këtë listë prej pesë problemeve figurojnë vetëm ato probleme të cilat mund të zgjidhen me anë të punës së kryetarit të komunës.

2009 kjo lagje kishte ujë 1-2 orë në ditë. Më 2011 ka pasur disa investime, por tërë investimi i Komunës nuk ka arrit që të furnizoj me ujë këtë lagje me më shumë se 8-9 orë në ditë. I tërë ujësjellësi i këtyre lagjeve menaxhohet nga miniera, kurse Komuna është dashur të ndërtojë disa herë për sanimin e prishjeve apo pagesën e një pjese të borxhit të banorëve.

Ujësjellësi në Llabjan dhe Koznicë është funksional, mirëpo fatura e rrymës për operimin e pompave të ujësjellësit ka arritur në 23.000 euro borxh i papaguar. Komuna dhe banorët ende nuk e kanë shlyer këtë borxh ndaj KEK dhe nuk përjashtohet mundësia që KEK-u të shkyç edhe këtë lokalitet nga rrjeti.

Në përgjithësi, Komunës së Novobërdës i mbetet ende shumë për të bërë për të zgjidhur problemin e ujit të pijes.

2.2. Mungesa e transportit publik

Problem tjetër i potencuar nga qytetarët në fushatën zgjedhore të 2009 ishte edhe mungesa e transportit publik. Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Novobërdës ndodhet larg rrugës magjistrale Prishtinë-Gjilan, rrugë në të cilën ka qarkullim të shpeshtë të autobusëve dhe taksive. Kurse rruga që lidhë fshatin Llabjan të Novobërdës me Komunën e Kamenicës, nuk është e frekuentuar nga autobusët. Kompanitë private të bartësve të udhëtarëve nuk kanë përfitim ekonomik që të operojnë në këtë rrugë. Si rrjedhojë, banorëve të kësaj komune u duhet të ecin me kilometra të tërë për të arritur në fshatin Llabjan – ku mund të kenë qasje në transportin publik, ose të presin autobusët të cilët janë angazhuar nga komuna dhe qarkullojnë tri herë në ditë.

Rruga kryesore nga fshati Llabjan deri në Komunën e Kamenicës është dëmtuar dhe kërkon intervenim në sanimin e gropave dhe asfaltim të ri të rrugës. Kur i shtohet kësaj edhe mungesën e mirëmbajtjes adekuate dimërore të rrugëve, Komuna e Novobërdës është e pakalueshme për automjete të rënda në sezonin e dimrit.

E tëra që ka bërë Komuna gjatë këtyre dy vite e gjysmë është rregullimi i vend pritjeve për udhëtarë të autobusëve. Në vitin 2011 Komuna ka investuar 37.250 euro për ndërtimin e kabinave pritëse për udhëtarë.

Është pak e besueshme se kompanitë private të transportit të udhëtarëve do të qarkullojnë në këtë komunë, ngase nuk mund të gjenerojnë fitim. E vetmja mundësi mbetet mbështetja financiare e Komunës për linjat e transportit publik.

2.3. Mbeturinat

Si komunë e vogël dhe me potencial për zhvillimin e turizmit malor, menaxhimi i mbeturinave ka qenë sfidë e potencuar në fushatën zgjedhore të 2009. Kompania regjionale "Higjiena" nuk ka operuar në Komunën e Novobërdës. Pas vizitave të qytetarëve në Kalanë e Novobërdës, sidomos në muajin maj të çdo viti, hapësira përreth Kalasë mbushet me mbeturina.

Më 2011, me mbështetjen e programit DEMI³ të USAID, Kompania "Higjiena" ka themeluar një njësi për operim në Komunën e Novobërdës, kurse DEMI ka financuar blerjen e 50 kontejnerëve të cilët janë vendosur në lokalitete të ndryshme të Komunës. Kompania "Higjiena" tani ngarkon vizitorët e Kalasë dhe Stanishorit që të paguajnë nga 1€ për mbeturinat (vetëm në muajin maj, kur vizitat në këto dy lokalitete janë më të mëdha në numër). Por, kjo ngarkesë prej 1€ është bërë pa ndonjë vendim të Kuvendit Komunal të Novobërdës dhe pa i njoftuar paraprakisht vizitorët. Kushtëzimi nga administrata komunale në lëshimin e dokumenteve, duke kërkuar edhe shlyerjen e borxhit për mbeturinat, ka bërë që qytetarët të paguajnë edhe shërbimin për grumbullimin e mbeturinave.

Në përgjithësi gjendja e ambientit dhe menaxhimi i mbeturinave është më mirë se sa në vitet paraprake, por zgjidhja aktuale e Komunës (përmes mbështetjes së DEMI) nuk është e qëndrueshme. Andaj, që tani Komuna duhet të hartojë një plan për menaxhimin e mbeturinave pas përfundimit të mbështetjes nga DEMI (USAID).

2.4. Gurëthyesi

Operimi i një gurëthyesi afër Kalasë së Novobërdës, me leje të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kishte irrituar një pjesë të banorëve të Komunës së Novobërdës dhe vizitorët e shumtë të Kalasë. Mirëpo më 2010, pas presioneve të shumta, ky gurëthyes ka pushuar aktivitetin. Mirëpo hapësira ku është gërryer toka ka mbetur e pa pyllëzuar.

2.5. Mungesa e përkujdesjes ndaj objekteve historike

Novobërda njihet për Kalanë e saj. Edhe pse një objekt i shkatërruar pothuajse tërësisht, Kalaja e Novobërdës tërheq shumë vizitorë. Vizitat në këtë lokalitet bëhen edhe për shkak të pozitës gjeografike ku gjendet Kalaja. Por, në tërë këto vite ka munguar përkujdesja institucionale e Komunës së Novobërdës dhe institucioneve qendrore.


³ DEMI (Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive) është projekt 3 vjeçar i USAID i dedikuar për të mbështetur 25 komuna të Kosovës.

Përveç pastrimit të mbeturinave përreth Kalasë, nuk ka ndonjë investim tjetër në Kalanë e Novobërdës. Restaurimi i Kalasë dhe rregullimi i infrastrukturës përreth, mund ta bëjë Novobërdën një atraksion turistik veror dhe t'i sjell të hyra më të mëdha buxhetit të Komunës dhe bizneseve lokale.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Novobërdës

Komuna e Novobërdës është në mesin e komunave me buxhetin më të vogël në Kosovë.⁴ Kjo si pasojë e aktivitetit të ulët ekonomik, pasi se Komuna e Novobërdës ka të hyra të pakta vetanake. Pas procesit të decentralizimit, me ç'rast Komunës së Novobërdës iu shtuan pjesë të territorit të Komunës së Kamenicës dhe Gjilanit, të hyrat vetanake kanë shënuar rritje. Rritje të të hyrave vetanake është shënuar kryesisht nga tatimi në pronë, taksat ndaj mjeteve motorike, lëshim i dokumenteve personale për qytetarë, etj. Grafikoni nr.1 pasqyron nivelin e të hyrave vetanake ndër vite.

Zakonisht, Komuna e Novobërdës planifikon të hyra në një nivel shumë më të ulët se sa që realisht ekzistojnë mundësitë e të hyrave vetanake për këtë komunë. Në vitin 2011 Komuna e Novobërdës kishte planifikuar të hyra prej 29.063 euro, kurse realizimi në fund të vitit ishte mbi 92 mijë euro apo një diferencë prej 318%. Kjo pastaj nga zyrtarët komunal reklamohet si "tejkalim i parashikimeve".




Burimi: Ministria e Financave – Pasqyrat Financiare 2011, Tabela e Buxhetit të Kosovës për 2012; Raporti Vjetor i Kryetarit të Komunës së Novobërdës për 2011.

⁴ Buxhet më të vogël se Komuna e Novobërdës kanë vetëm Ranillugu, Parteshi, Klllokoti, Mamusha dhe Juniku.

Edhe për vitet në vijim, planifikimi i të hyrave vetanake është më i ulët se realizimi në vitin 2011. Ky planifikim i të hyrave vetanake nuk është i saktë, ngase nëse shohim strukturën e të hyrave vetanake, të gjitha të hyrat janë të vazhdueshme dhe të përsëritshme (siç është tatimi në pronë). Shtu kësaj edhe rritjen e tatimit në pronë dhe taksën për regjistrim të automjeteve, të hyrat vetanake të Komunës së Novobërdës për 2012 dhe vitet në vazhdim do të jenë mbi 100 mijë euro në vit.

Buxheti i planifikuar për 2012 është 2.2 milion euro. Mirëpo, edhe buxheti i 2012 dhe planifikimet për 2013 dhe 2014 nuk janë reale, ngase Komuna e Novobërdës më 2011 ka pasur të hyra më të mëdha se sa plani për vitet 2012-2013. Kjo dëshmon edhe një herë për një planifikim jo të mirë buxhetor nga ana e zyrtarëve të Komunës.



Nga viti 2013, me ndryshimin e kriterëve për ndarjen e grantit qeveritar për komuna, Komuna e Novobërdës pritet të ketë të hyra më të mëdha. Pas decentralizimit, Novobërda ka më shumë banorë. Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të popullsisë Komuna e Novobërdës ka 6.720 banorë, apo 2.700 banorë më shumë se sa është konsideruar se ka kjo Komunë. Granti më i madh qeveritar prej 2013 dhe të hyrat vetanake më të mëdha, dëshmojnë se buxheti i Komunës së Novobërdës për vitet 2012-2014 do të jetë më i madh se sa planifikimet.

3.1. Investimet kapitale

Për shkak të buxhetit të vogël, Komuna e Novobërdës investon shumë pak në projekte kapitale. Gjatë viteve 2010 dhe 2011, Komuna për projekte kapitale ka investuar në total 2.058.613 euro. Prej të cilave 793.610 euro në vitin 2010 dhe 1.265.003 në 2011. Komuna e Novobërdës ka arrit të shpenzoj mjaft mirë buxhetin e dedikuar për investime kapitale.

Në vitin 2011 kjo komunë ka shpenzuar 96.24% të buxhetit të dedikuar për këtë kategori.

Disa nga investimet më të mëdha kapitale gjatë këtyre viteve janë:

Tabela nr.1: Disa nga investimet kapitale 2010-2011 në Komunën e Novobërdës

Viti	Projekti	Shuma (euro)
2010	Asfaltimi i rrugës Mendollak	100.000
2010	Rregullimi i shtratit të lumit Llabjan	4.000
2010	Rregullimi i rezervuarit të lumit në Bërdë	10.000
2010	Gëlqerosja e objekteve të shëndetësisë	15.000
2010	Rritja e fondit të librave për bibliotekë	5.000
2010	Ndërtimi i katit në shkollën fillore "Asdreni"	92.000
2010	Ndërtimi i ujësjellësit në Tamiqevc	9.304
2011	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Baqevisht	107.470,00
2011	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Koretisht	39.900,00
2011	Asfaltimi i rrugës Strazh-Kish	30.680,00
2011	Ndërtimi i objektit shkollor ne fshatin Bolevc	47.299,00
2011	Ndërtimi i kabinave për pritjen e Autobusëve	37.257
2011	Ndërtimi i trotuarit ne fshatin Llabjan	23.254
2011	Renovimi i rjetit te ujësjellësit në Novobërdë	102.000

Për vitin 2012 Komuna ka ndarë 527.940 euro për investime kapitale, ku pjesa më e madhe apo 93% e buxhetit për investime kapitale është buxhet i ndarë nga granti qendror, kurse vetëm 7% është buxhet nga të hyrat vetanake të Komunës. Sipas listës së investimeve kapitale për 2012, Komuna e Novobërdës do të investojë në asfaltim të rrugëve (290.000 euro apo 55% të buxhetit për investime kapitale); participim në projekte të ndryshme (94.940 euro apo 18% e buxhetit për investime); gëlqerosje (34.500 euro apo 6.5%); ujësjellës (50.000 euro apo 9.4% e buxhetit për investime kapitale), etj.

3.2. Menaxhimi me paranë publike

Raportet e Auditorit të Përgjithshëm nuk japin pasqyrë të mirë me menaxhimin e parasë publike në Komunën e Novobërdës. Madje kjo Komunë për disa vite përsërit lëshimet e njëjta në menaxhimin me paranë publike. Raporti i fundit i Auditorit të Përgjithshëm, ai i vitit 2010, gjen se Komuna e Novobërdës nuk ka përmbushur

rekomandimin e Auditorit Gjeneral të përsëritur që nga 2007 që kjo Komunë të përforcojë kontrollin e brendshëm financiar, posaçërisht në lidhje me barazimin e të hyrave të regjistruara në departamentin e kontabilitetit me departamentet tjera.⁵ Ky lëshim i Komunës së Novobërdës është klasifikuar si rrezik i lartë nga ana e Auditorit. Auditori i Përgjithshëm ka evidentuar edhe këto shkelje nga ana e Komunës së Novobërdës:

- Departamenti i kontabilitetit të Komunës nuk ka zhvilluar dhe implementuar procedurat e duhura për të kontrolluar më me efektivitet grumbullimin e pagesave nga lëshimi i licencave për biznese, si dhe të hyrave nga tatimi në pronë. Departamenti i kontabilitetit nuk mban regjistra dhe regjistrime të duhura, të mjaftueshme, të detajuara apo të rregullt të borxhlinjve të saj.
- Gjatë auditimit është vërejtur dobësi thelbësore në dizajnimin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme të komunës, posaçërisht në lidhje me regjistrimin e rregullt dhe pagesave të shpenzimeve;
- Nuk ka proces të barazimit ndërmjet departamenteve të cilat mbledhin të hyrat vetanake. Mungesa e barazimeve të rregullta mund të qoj deri te mos identifikimi i gabimeve në kohë të duhur dhe veprimet korrigjuese do të zbatohen vështirë;
- Dosjet e personelit nuk janë complete. Aty mungojnë shpalljet e konkurseve në gazeta, mungon lista e ngushtë e kandidatëve të ftuar në intervistë, referencat e tyre dhe përshkrimi i vendit të punës, mungojnë CV e të punësuarve, kontratat nuk janë përditësuar sipas ndryshimeve të fundit, etj.

Në Komunën e Novobërdës nuk funksionon asnjë bankë. Si rrjedhojë të gjitha pagesat e qytetarëve bëhen tek arkëtari i Komunës i cili pastaj i derdh ato në xhirollogari të Komunës. Kjo është në kundërshtim me ligjet e menaxhimit financiar. Mirëpo, Komuna është e pafuqishme të gjejë tjetër zgjidhje, ngase nuk mund të detyrojë qytetarët që të shkojnë në Gjilan për t'i bërë pagesat e tyre.

Raportimet financiar të Komunës së Novobërdës nuk janë të plota asnjëherë. Raportet financiare tre, gjashtë dhe nëntë mujore si dhe raporti përfundimtar vjetor nuk përmbajnë të dhëna të detajuara për shpenzimet e komunës për karburante, dreka zyrtare, shpenzime të komunikimit, etj. Në kërkesën e Institutit GAP për të pasur qasje në shpenzimet e detajuara të Komunës së Novobërdës për 2011, Komuna nuk ka dërguar raportin vjetor financiar, por vetëm të dhëna të përgjithshme për kategori të ndryshme të shpenzimeve (shih Tabelën nr.2).

⁵ Komuna e Novobërdës. Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Tabela nr.2: Shpenzimet e Komunës së Novobërdës 2011

Kategoria	Shuma (Euro)
Shpenzimet për internet	180
Shpenzimet e telefonisë mobile	6.870,78
Shpenzimet postare	786,88
Derivate për gjenerator	380,02
Karburant për vetura	42.970,35
Dreka zyrtare	7.377,65
Shpenzimet telefonike	8.451,07
Objektet arsimore	97.808,29
Objektet shëndetësore	40.850,80
Objektet kulturore	9.980
Objektet sportive	8.934,72
Ndërtimi i rrugëve lokale	513.280,26
Trotualet	7.200
Kanalizimi	384.600,45
Ujësjellësi	113.170,67
Rrjeti i rrymës	9.950
Kamion	46.200
Kapital tjetër	33.028,08

Siç mund të shihet nga tabela, Komuna e Novobërdës ka shpenzuar një shumë të konsiderueshme për karburant për vetura, mbi 42 mijë euro. Për shpenzimet e telefonisë (fikse dhe mobile) janë shpenzuar 15.321,85 euro. Komuna ka nxjerr vendim në fillim të 2010 që nga 40 euro mbushje telefoni t'i dedikohen kryetarit, nënkryetarit, drejtorëve; 30 euro kryesuesit të kuvendit si dhe nga 10 euro këshilltareve/asamblistëve komunal. Vendimi është zbatuar te rasti i drejtorëve, por jo edhe të këshilltarët të cilët thonë që asnjëherë nuk kanë marr mbushje të tilla. Drejtorët, përveç marrjes se mbushjeve, në të gjitha zyrat e tyre shfrytëzojnë edhe telefonat fiks. Kurse për dreka zyrtare janë shpenzuar mbi 7.000 euro. Në mungesë të raportit të detajuar financiar për shpenzimet 2011, nuk është e mundur që të krahasohet shpenzimi për këto kategori edhe për vitin 2010.

Në disa raste Komuna e Novobërdës ka bërë shpenzime të panevojshme dhe të paarsyeshme buxhetore. Shpenzime të tilla të buxhetit, si për shembull, janë organizmi i vizitave të shpeshta të stafit të Komunës për në Shqipëri. Në korrik të 2011 një pjesë e stafit teknik-administrativ-politik dhe këshilltarët komunal kanë shkuar në det në Shqipëri (Durrës) për qëndrim katër ditor. Shkuarja në Shqipëri e gjithë stafit është përsëritur edhe para 28 nëntorit të 2011. Kësaj radhe janë vizituar pothuajse gjithë qytetet në Shqipëri.

Komuna i heq obligimet e rrymës për minierën e Novobërdës. Mbi 50 mijë euro llogariten të shpenzuara në këtë drejtim nga viti 2008 e këndej. Kjo nuk është bërë me vendim të Kuvendit Komunal, por vetëm të Zyrës së Kryetarit. Asnjëherë nuk ka pasur ndonjë shpjegim për këtë se pse komuna paguan rrymën një kompanie e cila nuk është nën menaxhimin komunal.⁶

Komuna e Novobërdës ka shpenzuar mjete edhe për rregullimin e rrjetit elektrik, edhe pse një investim i tillë do të duhej të bëhej nga KEK – si ndërmarrje e cila menaxhon me rrjetin elektrik. Komuna e Novobërdës ka dhënë 9.804 euro për ndërtimin e rrjetit elektrik në Makresh të Epërm, 3.800 euro, prej tyre kanë qenë participim i vetë banorëve të kësaj lagjeje. Punët i ka kryer kompania “Bogdat”. Kontrata është lidhur me datë 04.05.2012. Po ashtu komuna e Novobërdës ka ndërtuar rrjetin elektrik në lagjen Mehmetaj me kosto të shpenzimeve të cilat kanë kapur shifrën e 9.950 euro.

Komuna e Novobërdës me datë 02.09.2011 ka marr vendim për t’i ndarë një parcelë të tokës komunale PTK-së, sipërfaqja është 300 metra katror. Në vendimin e nxjerr nga komuna nr.00080 thuhet se PTK-ja ka të drejtë të shfrytëzojë tokën për 10 vite. Përfitimi i komunës nga ndarja e kësaj toke është 273 euro në muaj.

3.3. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Njësia e Prokurimit në Komunën e Novobërdës, sipas organogramit të administratës së komunës, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka vetëm një të punësuar – menaxherin e prokurimit. Për dy vite (2010-2011) Komuna e Novobërdës ka lidhur 189 kontrata të prokurimit, me një vlerë të përgjithshme prej 2.796.153,32 euro.

Tabela nr.3: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Novobërdës
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	107	1.886.116,13
2011	82	910.037,19

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Të gjitha kontratat në vitin 2011 janë dhënë kompanive të cilat kanë ofruar çmimin më të ulët dhe asnjë kontratë nuk është lidhur në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm.”

Disa nga aktivitetet e prokurimit gjatë këtyre dy viteve janë:

⁶ Kjo problematikë është diskutuar edhe në mbledhjen e Kuvendin Komunal, si qështje e ngritur për diskutim nga anëtari i KK Ramush Mehmeti (AKR).

- Lidhja e rrymës nga trafoja e KEK-ut deri të Qendra Sportive me distancë rreth 200 metra i ka kushtuar komunës 7.160 euro. Punët teknike të kryera janë: vendosja e dy shtyllave të betonit dhe një kablo e gjatë afro 200 metra. Punët janë kryer nga kompania “Elmondi”.
- Furnizimi me lodra për fëmijë në oborrin e shkollës “Asdreni” në Llabjan ka kushtuar 9.980 euro. Lodrat janë kontraktuar nga kompania “Daqa”. E njëjta kompani, “Daqa” nga Ferizaj, ka marr 4.995 euro nga Komuna e Novobërdës (me datë 25.10.2010) për furnizimin me lodra për fëmijë në oborrin e shkollës “Asdreni” në Llabjan.
- Servisimi i veturës së Kryetarit të Komunës, e cila është kryer nga kompania “Ascom Group shpk”, ka kushtuar 2.506 euro. Servisimi është bërë më datë 12.08.2010.
- Objekti i thertores në Llabjan, ndërtimi i së cilit i ka kushtuar Komunës afro 50.000 euro, është jo funksional. Pas ndërtimit është konstatuar se objekti nuk i plotëson kriteret për therjen e kafshëve dhe i gjithë projekti për ndërtimin e tij ka qenë gabimisht i hartuar. Kjo thertore është ndërtuar afër tregut të kafshëve, me qëllim që therja e kafshëve të bëhet në një ambient më të sigurt dhe jo në ambient të hapur, ashtu siç ndodh ende. Ndërtimi i objektit të thertores është bërë nga kompania “Coing”.
- Komuna e Novobërdës pjesën dërrmuese të kategorisë së mallrave i siguron nga shitoretja “Ola” e cila menaxhohet nga zyrtari i kësaj komune Sylejman Avdyli (Menaxher i Personelit në Komunën e Novobërdës). Kjo shitore ndodhet në fshatin “Llabjan” mirëpo nuk mban shënim të dukshëm të emërtimit, edhe pse kjo është e ndalushme me ligjet në fuqi – nëse një kompani nuk e reklamon emrin e kompanisë. Në 2011, Komuna e Novobërdës i ka dhënë tender shitores “Ola” katër herë, me vlerë të përgjithshme prej 7.092,95 euro:
 - Furnizim me material higjienik për institucionet e KK (1.887,45 euro);
 - Furnizim me material higjienik dhe ushqimor (3.271 euro);
 - Furnizim me pije dhe ushqim për shkolla dhe byfëne e komunës (942,50 euro);
 - Furnizim me pako ushqimore për familjet e skamnorëve me rastin e Fitër Bajramit (992 euro).⁷

⁷ Komuna e Novobërdës. Raporti Vjetor i Kryetarit të Komunës për vitin 2011.

4. Arsimi

Në Komunën e Novobërdës funksionojnë nëntë shkolla fillore dhe 13 paralele të ndara, gjithsej personel i angazhuar në nëntë shkolla fillore dhe 13 paralelet e ndara janë 194 të punësuar. Komuna e Novobërdës po ashtu ka tri shkollë të mesme, me gjithsejtë 54 të punësuar. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në shkollat fillore dhe të mesme, 188 janë mësimdhënës, ndërsa 69 të punësuar mbajnë pozitën e ndihmësit teknik dhe në administratë.

Investimet në infrastrukturën e shkollave në Novobërdë janë bërë kryesisht nga donatorët e huaj dhe janë të pakta investimet komunale në këtë drejtim. Kësisoj, shkolla fillore "Asdreni" është bërë me kabinet të informatikës nga një investim i Bankës Botërore. Nisja e ndërimit të objektit të ri mësimor për shkollën "Nushi & Tefiku" është mundësuar nga Komisioni Evropian. USAID-i ka mundësuar hapjen e klasës për mësim bazik në shkollën fillore "Asdreni". Po ashtu në dy shkolla fillore në fshatin Kufc dhe Njegosh – Komisioni Evropian përmes fondeve të IPA-së ka investuar në ndryshimin e sistemit të energjisë dhe kalimin e saj në energji efikente. Është rregulluar i oborri i shkollës fillore dhe të mesme të Ulët "Minatori" në Novobërdë me fonde të projektit "Kosova e Bukur" nga MASHT-se, me vlerë prej 30 mijë euro. Me fonde të Komunës së Novobërdës ka nisur së ndërtuari shkolla fillore në fshatin Bolec në vlerë prej 50.000 euro, Po ashtu me fonde të Komunës është ndërtuar edhe një kat në shkollën fillore "Asdreni" në Llabjan në vlerë prej 92.000 euro.

5. Shëndetësia

Struktura e shëndetësisë komunale përbëhet prej Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) me tetë të punësuar, e cila gjendet në lagjen "Kolonia e Vjetër"; dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) në Prekoc, Kufcë, Koretishtë, Llabjan; punktet shëndetësore në Tullar, Makresh dhe Stanishor.

Një nga sfidat me të cilat përballet Komuna e Novobërdës është edhe pagesa e rrymës për institucionet shëndetësore. Në raportin vjetor 2011 të Komunës së Novobërdës, në pjesën për Drejtorin e Shëndetësisë, specifikohet se kjo drejtori ka marr përsipër kryerjen e pagesave, siç thuhet enorme, të energjisë elektrike dhe telefonave për ambulancën dhe Qendrën për Punë Sociale në fshatin Bostan.

Komuna e Novobërdës shpenzon rreth 90.000 euro në vit për furnizimin e shkollave dhe qendrave mjekësore me dru dhe thëngjill për ngrohje. Andaj, shpenzimi enorm i energjisë elektrike për këtë qëllim shihet si krejt i pa nevojshëm dhe i pa arsyeshëm.

Në Komunë të Novobërdës ka vetëm një mjek familjar dhe dy stomatolog të cilët ofrojnë konsultime dy here në javë. Komunat janë të obliguara të ofrojnë shërbime shëndetësore 24 orë të paktën në një qendër shëndetësore. As QKMF dhe as dy QMF dhe asnjëra nga punktet shëndetësore nuk punon 24 orë. QKMF dhe QMF punojnë vetëm nga ora 8:00 deri në ora 16:00, ndërsa punktet shëndetësore vetëm 1 herë në javë, zakonisht të mërkurave. Po ashtu, në 95% të rasteve aparatura e cila ekziston në këto qendra mjekësore është e vjetruar dhe nuk ka pasur investime në këtë drejtim.

6. Administrata komunale

Në administratën komunale të Novobërdës janë të punësuar 80 veta. Ndarja e punëtorëve komunal nëpër departamente nuk është e rregullt. Vërehet koncentrimi i një numri relativisht të madh të të punësuarve në ato drejtori që kanë më pak punë dhe mungesa e numrit të duhur të stafit në ato sektore ku kërkohet aktivitet i përditshëm dhe i rëndësishëm. Kësisoj, Drejtoria e Inspektionit ka vetëm një të punësuar, përkatësisht drejtorin e drejtorisë i cili është i emëruar, ndërsa Drejtoria e Kulturës ka 8 të punësuar. Rasti tjetër i ngjashëm haset edhe me Drejtorin e Katastrit dhe Gjeodezisë ku ka vetëm një të punësuar, ndërsa zyra për komunitete dhe kthim ka pesë të punësuar. Po ashtu Drejtoria e Shëndetësisë përbëhet nga vetëm një person (Drejtori).

Komuna e Novobërdës për gati dy vite nuk ka Drejtor të Administratës dhe kjo drejtori udhëhiqet nga një ushtrues detyre, Xhemajl Novobërdaliu, i cili njërit është edhe Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë. Ligji për vetëqeverisje lokale lejon që një drejtori të udhëhiqet me ushtrues detyre maksimalisht deri në 6 muaj.

Qendra për Shërbime të Qytetareve ballafaqohet me problemin e zbatimit të kushtëzimeve ndaj palëve, lidhur me pagesën e tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave komunale. Palët shumë herë reagojnë duke pyetur përse ju kushtëzohet shërbimi me pagesën e tatimit në pronë dhe detyrimet tjera. Duke qenë komunë e vogël, qytetarët shfrytëzojnë lidhjet e tyre farefisnore dhe miqësore për të mos i paguar detyrimet ndaj Komunës dhe duke e marr shërbimin.

Kryetari i Komunës ka punësuar gjashtë persona pa pasur konkurs për vendet e tilla të punës, në mesin e të punësuarave është edhe nipi i kryetarit i cili është angazhuar në Drejtorin e Financave - Driton Mustafa.

Raporti i Auditorit Gjeneral ka gjetur shumë mangësi sa i përket konkurseve, ruajtjes së dokumentacionit për personat e intervistuar për pozita në Komunë, përshkrimi i vendeve të tyre të punës, etj.

7. Transparenca

Transparenca në Komunën e Novobërdës nuk është në nivelin e dëshirueshëm. Përgjigja në kërkesat për qasje në dokumente zyrtare zakonisht janë përgjigje të mangëta, pa ofruar dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Uebfaqja e Komunës së Novobërdës nuk përmban informacionet për çdo aktivitet të Komunës dhe nuk përmban të gjitha raportet periodike, por as procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve dhe Kuvendit Komunal. Madje, procesverbalet e Kuvendit Komunal për vitin 2010 Komuna nuk i ka të ruajtura fare në mënyrë elektronike.

Tabela nr.4: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Novobërdës
<http://kk.rks-gov.net/novoberde/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	√	√	√	√	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbaniz., Kadast. dhe Mb.Mjedisit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurorit	Janë të publikuara 41 njoftime të prokurorit. Ky numër është shumë i vogël, ngase vetëm kontrata të nënshkruara për vitet 2010-2011 do të duhej të ishin të publikuara 189 njoftime.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				√				√

Rregulloret Komunale	Dy rregullore komunale janë të publikuara: Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba dhe Rregollurja e tatimit në pronë.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	x			x					x
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	Janë të publikuara: Plani i Punës i KK për 2012 dhe Strategjia Zhvillimore Lokale.								

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar ne uebfaqe.

8. Puna e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal i Novobërdës përbehet prej 15 anëtarëve. LDK ka numrin më të madh të anëtarëve. Partitë shqiptarë kanë dhjetë anëtarë, kurse partitë serbe pesë anëtarë.

Tab. Nr.5: Përbërja e Kuvendit Komunal të Novobërdës

Partia	Nr. i anëtarëve
LDK	5
PDK	2
AKR	2
ZBB	2
SNSD	2
AAK	1
SLS	1

Kuvendi i Komunës së Novobërdës gjatë një viti mbledhet më së shumti deri në 10 herë. Po kaq mbledhje mban edhe Komiteti për Politikë e Financa, organ ky urelidhës mes ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal.

Në raportin e MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) vihet në pah se gjatë monitorimit të mbledhjeve është vërejtur se në fillim të mbledhjes te Kuvendit nuk bëhet konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit, edhe pse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit ka kuorum për marrjen e vendimeve. Në përgjithësi, grupet parlamentare zhvillojnë debat të hapur në të gjitha çështjet që diskutohen në Kuvend.

Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për publikun dhe në të marrin pjesë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare por edhe të atyre vendore, mediat, si dhe qytetarë të interesuar. Një nga përgjegjësit e Kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur raport para Kuvendit Komunal për gjashtë mujorin e parë të 2011.

Këshilli komunal për siguri mblidhet vetëm njëherë në vit, ndonëse me rregullore është e precizuar që duhet t'i këtë se paku 10 takime të tilla. Në të njëjtën rregullore precizohet se raportet nga këshilli për siguri i dërgohen Kuvendit Komunal, asnjëherë asnjë raport i tillë nuk i ka shkuar Kuvendit.

Në periudhën e fundit, përkatësisht janar - mars të këtij viti 2012, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar gjithsej 18 akte komunale, prej tyre 16 vendime dhe 2 rregullore.

9. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetari i Komunës z. Bajrush Ymeri (LDK), elektoratit i kishte prezantuar një program zhvillimor dhe me shumë premtime, përkundër asaj se ishte i vetëdijshëm se kapacitetet financiare të Komunës së Novobërdës ishin të vogla. Pas regjistrimit të të gjitha premtimeve të bëra gjatë fushata zgjedhore, më 2010 Instituti GAP dhe BIRN i patën shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës së Novobërdës z. Ymeri, ku ia patën përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre (Letra e GAP dhe BIRN: Instituti GAP dhe BIRN. Letër e hapur Kryetarit të Komunës së

Novobërdës z. Bajrush Ymeri. Maj 2010. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/LeterNovoberd.pdf>).

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 10 premtime të dhëna nga kryetari Ymeri. Premtimet e dhëna kryesisht janë premtime të përgjithshme dhe përkundër përpjekjeve dhe investimeve, nuk mund të konsiderohen si premtime plotësisht të përmbushura. Në këtë mënyrë, nga dhjetë premtimet të cilat kemi arritur ti evidentojmë gjatë fushatës elektorale të 2009 dhe të cilat i kemi monitoruar gjatë viteve 2010/2011 e deri në qershor 2012, katër nga premtimet e dhëna nuk kanë filluar fare së realizuari, kurse gjashtë premtime të tjera janë realizuar pjesërisht.

Premtimet e dhëna	Ecuria e realizimit
Arsim dhe shërbime shëndetësore cilësor	Gjendja në arsim dhe shëndetësi vlerësohet e njëjtë me kohën e para fushatës zgjedhore. Janë bërë disa investime në infrastrukturën e shkollave dhe atë të shëndetësisë, por kjo nuk mund të merret si faktor i rritjes së cilësisë së shërbimit apo mësimin, përveç se ka ndikua pozitivisht në mbarëvajtjen e këtyre fushave. Është ndërtuar një kat shtesë i ambulancës në fshatin Kufc. Është ndërtuar objekti shkollor në fshatin Bolevc. Është blerë një veturë e ndihmës së shpejt për shtëpinë e shëndetit në Novobërdë. Është rinovuar shkolla në fshatin Stanishor dhe tek lagjja e Vllasalive. Është shtuar edhe për një kat shkolla fillore “Asdreni” në Llabjan.

<p>Një qeverisje transparente, efikase, moderne dhe të mbështetur në ligj e drejtësi</p>	<p>Transparenca në Komunë e Novobërdës nuk është e kënaqshme. Në disa raste komuna nuk i është përgjigjur kërkesave për qasje në informata zyrtare. Uebfaqja e Komunës së Novobërdës nuk është e pajisur me informacione dhe dokumente zyrtare.</p> <p>Partitë opozitare në Kuvendin Komunal (AKR dhe AAK) adresojnë kritika ndaj ekzekutivit për faktin që sipas tyre ekzekutivi asnjëherë nuk u kthen përgjigje në pyetjet që ata parashtrojnë apo në kërkesat që lansojnë në Kuvendin Komunal. Përgjigje nga ekzekutivi nuk i është kthyer asnjëherë as lëvizjes “Vetëvendosje” dega në Novobërdë, të cilët disa herë radhazi kanë kërkuar zyrtarisht përgjigje për disa investime dhe projekte në Novobërdë. E gjithë kjo tregon për nivel jo të kënaqshëm të transparencës në qeverisje. Po ashtu dhënia e tokës në shfrytëzim në se paku dy raste është evidentuar që është bërë jashtë parametrave ligjor, gjë e cila lë të kuptosh që premtimi për mbështetjen e politikeve në ligj e drejtësi nuk ka rezultuar gjithaq i përmbushur.</p>
<p>Ambient të pastër</p>	<p>Në ambient ka pasur progres evident. Pasi që LOGOS-a (organizatë zvicerane) ka financuar kompaninë për mbledhjen e mbeturina, kjo e fundit për një kohë është treguar më aktive në grumbullimin e mbeturinave, sidomos në qytetin e Novobërdës.</p>
<p>Ambient tërheqës për investime</p>	<p>Nuk ka pasur ndonjë nismë apo plan të caktuar i cili do të ndikonte në këtë drejtim dhe gjendja për sa i takon investimeve në Novobërdë ka mbetur e ngjashme me kohën e para fushatës zgjedhore. Në këtë lokalitet ndonëse ekziston “Kalaja e Novobërdës” që vizitohet në vazhdimësi, akoma nuk ka një lokal apo kafe bar ku mund të pushonin e relaksoheshin vizitorët. Ekziston një nismë e Komunës së Novobërdë dhe asaj të Gjilanit për hapjen e një zone ekonomike ne fshatin Llabjan, mirëpo kjo ka mbetur ende vetëm ne letër.</p>

Prodhimin e rrymës me erë	Kjo nuk është bërë. Madje me legjislacionin aktual komunat nuk kanë kompetencë në lëshimin e lejeve për operatorët e prodhimit të energjisë. Licencat për prodhim të energjisë me erë janë kompetencë e Zyrës së Rregullatorit për Energji.
Hartimin e planit zhvillimor në vlerë prej 80.000 euro - me vëmendje të veçantë në zhvillimin ekonomik të komunës	Kjo ka nisur tek tani, akoma pune është në nivel të draftit dhe nuk ka ndonjë kohë të përcaktuar për përmbylljen e kësaj çështje.
Themelimin e ndërmarrjeve komunale që do të merren me menaxhimin të ujërave, mbeturinave dhe kanalizimeve	Kjo nuk është bërë dhe as që ka pasur ndonjë përpjekje në këtë drejtim. Madje vetë ligjet në fuqi nuk lejojnë ende një gjë të tillë.
Sigurimin e ujit të pijshëm për fshatrat që nuk kanë ujë ku si zgjedhje alternative do të jenë burimet në fshatrat Qylkoc dhe Tullar	Kjo është realizuar pjesërisht. Novobërda në përgjithësi përballet me mungesë të ujit të pijes, pa ujë të pijes është edhe vetë objekti i komunës, shkolla e mesme në fshatin "Boston" si dhe ambulanca në fshatin Llabjan. Është ndërtuar rrjeti i ujësjesit në Qylkoc dhe Tullar, por kjo nuk e ka zgjidhur problemin e ujit të pijes, pasi që banorët nuk i kanë paguar faturat e rrymës për operimin e pompave të ujësjesit dhe si pasojë atyre u është ndërprerë furnizimi me ujë.
Kanalizimin për shtëpitë që nuk janë të kyçura në rrjet	Është punuar në instalimin e kanalizimit në disa lokalitete të Novobërdës, por janë hasur edhe zona ku është rregulluar kanalizimi, ndërsa disa shtëpi nuk kanë mundur të kyçen në rrjedhën e saj.
Për fshatin Qyllkoc: rregullimin e kanalizimit.	Kjo është realizuar pjesërisht.

10. Burimet

Raportet:

1. Komuna e Novobërdës. Raporti i buxhetit i Komunës së Novobërdës 2010.
2. Komuna e Novobërdës. Raporti i buxhetit i Komunës së Novobërdës 2011.
3. Raporti i punës i ekzekutivit komunal të Novobërdës 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/novoberde/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raport-i-Kryetarit-te-Komunes-per-vitin-2011-Final.pdf.aspx>.
4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Raporti mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë 2010.
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Raporti mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë 2010.
6. Raporti vjetor i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Novobërdës (2010).
7. Komuna e Novobërdës. Rregullorja komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.
8. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për 2012.
9. Korniza Afat-mesme e Shpenzimeve 2010 -2013

Intervistat:

10. Lirim Gashi – udhëheqës i degës së “Vetëvendosjes” në Novobërdë
11. Avdullah Gashi – Kryetar i degës së AAK-së në Novobërdë
12. Ramush Mehmeti – Përfaqësues i AKR-së në Novobërdë